

Dalës-Izlazna

Nr. 1-32

Data 20.03.2023

Br.

Datum



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.28.02.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Valon Svirca (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar i Komunës për komunitete, drejtorët komunal, Daut Mjeku, shef i sektorit për ekonomi, Berat Mehmeti, zyrtar ligjor, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore dhe përf. e KFOR-it,

Mbledhjen e udhëhoqi Enver Gashi, anëtari më i vjetër i Kuvendit komunal, i cili, pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Sqyrtimi i Draft Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit
4. Raporti i Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2022
5. Plani i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2023
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Enver Gashi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës duke thënë se në pikën shqyrtimi i kërkesave në mbledhjen e KPF-së, jemi dakordue që të hyjnë 2 plotësim ndryshime të Rregullores për tarifa, ngarkesa

dhe gjoba komunale dhe të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave. Po ashtu, edhe të raportohet nga drejtoresha e administratës për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave.

Miratohet unanimisht rendi i ditës.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Vlora Mjekiqi Kabashi me arsye

Pika 2 e rendit të ditës

Labinot Mirena – Ne jemi të pajtimit për aprovimin e ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.

Sami Ahmeti – Paraqet vërejtje në ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme sepse në faqen nr.2 në vend të emrit gabimisht të shkruar “Sami Hamiti” duhet të jetë emri “Sami Ahmeti”.

Miratohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara me 13 vota për dhe 5 vota abstenim me vërejtjen e cekur më lartë.

Pika 3 e rendit të ditës

Enver Gashi – Paraqet shqyrtimin e Draft Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit. Ky Draft Kod Etik ka dalë në shqyrtim publik, i ka kryer të gjitha procedurat dhe tash është çështje e Kuvendit ta votoj.

Labinot Mirena – E falenderoj drejtoreshën e administratës për punën dhe kontributin e dhënë në Draft Kodin Etik dhe ne jemi për aprovimin e këtij dokumenti.

Sami Ahmeti – Në seancën e dhjetorit kur na është kërkuar për me lejue me dalë në debat publik ky Kod, ne e patëm dhënë pëlqimin atëherë me ironi i patëm cekë disa pika, kryesisht te pika 5 dhe 6 edhe pse patëm vërejtje se ato janë të kundërligjshme. Në ndërkohë, që tash këto ishin ndryshue, ne jemi dakord dhe nuk kemi asnjë vërejtje lidhur me këtë kod.

Ajet Berisha – Mendoj se Drafti fillestar ka qenë shumë më i mirë se sa që është tash, respektimi i vullnetit zgjedhor të qytetarëve. Kjo, do të thotë fjala vullnet zgjedhor i qytetarëve nuk nënkupton në këtë rast respektimin e ligjit sepse nenet tjera, e përcaktojnë. Ndërsa, respektimi në Draftin e parë ka qenë zyrtari politik duhet të kryej detyrën në përputhje me mandatin e dhënë nga elektorati dhe të mbroj interesin e përgjithshëm. Do të thotë është pikë e Draftit fillestar dhe nën 2, zyrtari politik duhet të respektoj vullnetin e votuesit deri në fund të mandatit duke zbatuar programin politik si dhe të shmang ndërrimin e partisë gjatë ushtrimit të mandatit. Këtu, jo që të ndalë gjithsesi por shumë mirë është e përshkruar, nuk bjen në kundërshtim me ligjin sa i përket kësaj si etikë sepse kjo nuk është vepër penale. Krejtë, në fund të kësaj Rregulloreje thotë se kjo vetëm qon në Komisionet disiplinore, në këtë rast as atë jo se Komision disiplinor në fund është vota e popullit. Mirëpo, ju e keni shëndrrue zyrtari politik kryen detyrat në përputhje me mandatin e dhënë nga ligji dhe mbron interesat e përgjithshme. Do të thotë nuk është në proporcion me përshkrimin e nenit për çka është respektimi i vullnetit zgjedhor të qytetarëve. Mendoj se Drafti fillestar e ka shumë më mirë se ju që e keni ndryshue, andaj unë jam që pika pika 5 të jetë sipas Draftit fillestar.

Lindita Bekteshi – Komisioni i përbërë prej 3 anëtarëve të emëruar nga Kryetari i Komunës, ka përpiluar Draft Kodin Etik për Komunën e Obiliqit. Ky Kod ka kaluar nëpër të gjitha procedurat e parapara ligjore, ka dalë në diskutim publik, me dt.13.01.2023, ndërsa debati publik është mbajtur me dt.27.01.2023, në ora 14 në sallën e Kuvendit komunal. Aty, është kërkuar nga pjesëmarrësit që të japin kontributin e tyre për të plotësuar, apo ndryshuar ndonjë dispozitë etike të këtij Draft Kodi. Përveç, nenit 5 që është kundërshtuar nga disa anëtarë të Kuvendit dhe i njejtë propozim është pranuar duke fshirë atë paragraf të nenit 5, propozime tjera, nuk kemi pasë nga të tjerët. Debati ka qenë i hapur për të gjithë, por nuk ka pasë asnjë anëtarë të Kuvendit, që ka qenë i pranishëm për të dhënë mendim, ose ndonjë propozim.

Ajet Berisha – Drejtoreshë, takimet publike të cilat i mbani për konsultim për çdo Rregullore janë të rëndësishme për juve me bë procesverbalin se cilat janë ato propozime. Ne asnjëherë prej asnjë takimi nuk kemi marrë procesverbal për propozimet e dhëna në ato takime. E dyta, unë marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit sikurse në propozimin për me dalë në debat publik kjo Rregullore, sikurse në miratimin e kësaj Rregulloreje dhe unë nuk kam nevojë me ardhë në ato debate publike sepse ato nuk janë për mua. Mbledhja e Kuvendit komunal është për mua dhe aty, është për ata që nuk marrin pjesë dhe nuk kanë të drejtë

me marrë fjalën sot. Unë në 2 takime për këtë Draft Rregullore marrë pjesë në momentin kur propozoj me dalë në debat publik dhe në momentin kur unë votoj për këtë Draft Rregullore. Pra, është në mënyrë të padrejtë me thënë nuk po vini në debate publike, s'kam nevojë, nuk e kam të detyrueshme sepse unë këtu, jam i thirrur, paguhem, kam marrë votën me dhënë mendimin tim këtu. Ju, mbani takime publike, por asnjëherë asnjë procesverbal nuk e keni sjellë nga ato takime publike dhe jeni të obliguar.

Lindita Bekteshi – Unë ju tregova se në debat publik nuk kemi pasë asnjë propozim, asnjë sugjerim përveç paragrafit 5 që kemi pasë prej juve, prej disa anëtarëve të Kuvendit dhe atë e kemi marrë parasysht dhe e kemi ndryshue.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për dhe 1 votë abstenim e aprovuan Kodin Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Pika 4 e rendit të ditës

Enver Gashi – Ju raportin e Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit e keni marrë të gjithë dhe hap debatin për këtë çështje.

Labiot Mirena – Unë e falenderoj jashtëzakonisht Kryetarin dhe të gjithë drejtorët për punën e bërë. Punët e mira të Kryetarit e kanë përsëritë mandatin e tij të tretë dhe do ti përsëritë edhe shumë mandate tjera, vetëm ju qoftë puna e mbarë.

Sami Ahmeti – Unë po flas për raportin dhe s'po flas për mandatet. Në fakt për raportin e shpenzimeve për vitin 2022 kuptojmë se Komuna e Obiliqit ka shpenzuar 4 milionë e 714,265 euro, apo 92.42 % të mjeteve të alokuara për investime kapitale. Rreth 45 %, e këtyre mjeteve apo 2.1 milionë euro, janë shpenzuar në 2 projekte që ende nuk kanë filluar. Bëhet fjalë për vazhdimin e sheshit “Adem Preniqi” ku janë paguar 200,000 euro, pra pa filluar puna si dhe kogjenerimi që janë paguar 1.9 milionë euro, për 2 gypa dhe një karrocë beton. Te raporti i drejtoreshës dhe ai i Prokurimit nuk jepen shifra të njejtë kur bëhet fjalë te pagesa e kogjenerimit, ndoshta edhe nuk kemi ditë me i lexue. I pari qfaqë shifrën prej 1 milionë e 888,387.21 euro, për kogjenerim për vitin 2022, ndërsa, raporti i Prokurimit thotë se janë shpenzuar 1 milionë e 480,870 euro, diferenca është 407,514 euro. Këto, 2 vërejtje do të jenë të gjetura të radhës të auditorit dhe besoj se edhe auditori i brendshëm ka qenë dashtë ti vërej dhe ti udhëzoj. Gjithsesi, unë kisha pasë dëshirë me marrë një shpjegim lidhur me këto gjëra, që nuk po përputhen në mes veti.

Ajet Berisha – Unë konsideroj se raporti është shumë voluminoz dhe kishte qenë mirë në kuptimin e atyre frazave, por edhe të përsëritjeve, gjërave që vërtetë mund të shkruhen me 2 fjali, e mos të na i mbushin me nga 2 faqe, për shkak të humbjes së kohës dhe për shkak se nuk po paraqet ndonjë aktivitet ku me ditë se çfare. Unë ato që i tha parafolësi i kam vënë në pah, por edhe një pyetje e kam për drejtoreshën. Në disa Drejtori kemi projekte me donacion që kapin vlera kogja të rëndësishme, e kemi Drejtorinë e Arsimit dhe e kemi Drejtorinë e shëndetësisë. Në disa nuk janë shëndrrue në vlera monetare, e në disa edhe janë të paraqitura, kështu në Drejtorinë e Arsimit janë 130,000 euro, janë të raportuara se janë fitim i donacioneve. Mua, më intereson se këto të hyra nga donacionet a janë të paraqitura në buxhetin përfundimtar edhe si e hyrë, a janë paraqitë veç si e dalë nga ky buxhet. Në rast se këto nuk janë paraqitë që mendoj se janë paraqitë, por nuk po e di se ku janë paraqitë atëherë, deficiti apo suficiti në këtë rast është më i madh mbi 700,000 por e kap vlerën mbi 1 milionë pavarësisht edhe asaj që e tha parafolësi se 2 milionë janë shpenzim i deklaruar pa pasë asnjë veprim në terren. Kjo, për juve ka dalë njëfarë mbrojtje në kuptimin e shpenzimit ndërsa, në praktikë punët në terren nuk janë ekzekutue, që është mirë me na i shpjegue drejtoresha.

Zarife Behluli – Sa i përket pyetjes së parë te objekti i kogjenerimit, unë nuk e di çka ka deklarue Prokurimi sepse unë vetëm raportin tim e finalizoj në bazë të raportit të sistemit të thesarit, që ne jemi obligativ me punue dhe aty nuk fshehet asnjë centë, e jo me qindra, mijëra qysh po thoni ju. Projekti i kogjenerimit ka qenë duke u punuar edhe objekti që 2 vite që ka fillue, që është mbikqyrja e projektit dhe pagesat që janë kryer për pajisjet që po thotë sa kanë kushtue. Përndryshe, çdo mjet që vjen jashtë Kosovës, kemi të drejtë me bë pagesën e 50 %-it. Te donacionet, çdo mjet që hyn në llogarinë bankare të Komunës së Obiliqit, këtu është e raportuar. Për donacionet që nuk kalojnë përmes bankës të Komunës së Obiliqit, ne

nuk raportojmë sepse nuk mundesh me raportu një mjet që nuk ka hy përmes thesarit në bankën e Komunës së Obiliqit. Përnyshe, raporti si raport është taman qysh është sistemi i thesarit dhe jemi barazuar me pasqyrat financiare.

Sami Ahmeti – Ju, na keni sjellë raport që përfshin edhe të Prokurimit.

Enver Gashi – Rreth raportit fjalën e pate, i ke shpenzue minutat, e ke krye.

Sami Ahmeti – Jo, nuk i kam shpenzue minutat, unë i kam 10 minuta dhe nuk e kam krye.

Pika 5 e rendit të ditës

Enver Gashi – Ju materialin e keni marrë Planin e punës të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2023 dhe besoj se e keni lexue.

Labinot Mirena – Kryesues, nuk kemi diçka të veçantë për planin e punës të Kryetarit vetëm vazhdo mbledhjen.

Enver Gashi - Nëse, nuk kemi diskutime, atëherë kalojmë në pikën tjetër.

Pika 6 e rendit të ditës

Enver Gashi – Paraqiti raportin e DEFZH-së, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale sipas Ministrive të linjave.

Sami Ahmeti – Nuk është që janë ndryshue Rregulloret, por është budallakia e njejtë që bëhet gjithmonë për shkak se nuk ka zyrtar ligjor, nuk ka këshilla ligjore. Këto, Rregullore, ose këto ndryshime në çdo seancë po na vijnë si të tilla dhe me gabime të njejtë sepse nuk ka kush lexon dhe nuk ka kush i komenton ligjet. Nuk ka asnjë ndryshim lidhur me këto Rregullore, bash i kam përcjellë, nuk ka asnjë ndryshim të Rregulloreve, as të Udhëzimeve administrative, por janë të njejtat që kanë qenë edhe para miratimit të tyre. Mirëpo, fatkeqësia është se është gjendja qysh është.

Daut Mjeku – Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, faktikisht që 2 herë vjen në Kuvend dhe nuk kalon. Arsyet janë të zyrtarëve ligjor të Ministrive të linjave dhe me disa Udhëzime administrative, gjithëherë. Në të kaluarën para se me shkue Rregullorja në Kuvend, Ministria e ka bërë aprovimin e vet, ndërsa tash njëherë duhet me ardhë në Kuvend, pastaj me shkue te zyrtarët ligjor. Kjo, është pengesa më e madhe, por te Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, te lejet e ndërtimit, lejet e rrënimeve dhe tarifave të infrastrukturës, ka dalë një Udhëzim administrativ në vitin 2022. Po ashtu, pritet çdo vit sepse lejet e ndërtimit shkojnë në bazë të një formule gjatë punës, sa leje i ke, sa është çmimi i atyre lejeve, sa punëtorë janë aty, do të thotë nxjerren në bazë të Komunës. Drejtoria i ka dërgu këto të dhëna në Ministri dhe pritet miratimi i Ministrisë, pastaj kemi me shkue në Ministri me i marrë të gjitha të dhënat që mos me na u kthye më ashtu, që kur vjen Rregullorja në Kuvend me kalue. Ne jemi bazuar në legjislacionin e Asociacionit të Komunave, ku thuhet se taksat janë të përpikëta. Ne si zyrtarë e kemi problem prej Udhëzimeve administrative me i marrë të dhënat dhe me i përpunue psh te trashëgimia, ose te bartja e pronës kush është rendi i parë, i dytë dhe kush është rendi i tretë. Qytetari nuk mund ti shohë këto dhe ne kemi mendue me shkue me një pjesë shtesë se përveç tatimit në pronë të gjitha taksat komunale të jenë në një vend, të jenë në faqen zyrtare të Komunës dhe të lexohen prej qytetarëve. Unë besoj se në Kuvend Rregullorja më nuk vjen pa u përmirësue përmes Ministrive të linjave, prej zyrtarëve ligjor. Ne do të kemi takime me ata dhe juve, do të ju vjen Rregullorja në Kuvend për miratim.

Labinot Mirena – Pyes, se a ndjehesh i ofenduar prej shefit të grupit parlamentar të LVV-së dhe a po vijnë Rregulloret me budallaki të madhe që tha se po na refuzohen.

Daut Mjeku – Unë, jo nuk ndjehem sepse ne këtu, jemi me debatue derisa të kryhen të gjitha procedurat.

Sami Ahmeti – Nuk ndjehet i ofenduar sepse nuk ishte qëllimi te ky pasi që ky nuk është zyrë ligjore. Ky është në një Komision, në të cilin ka marrë pjesë dhe ka dhënë maksimumin e vet. Mirëpo, edhe sot derisa nuk na ka ardhë Rregullorja prapa nuk ka pasë nevojë me futë si pikë të rendit të ditës. Mirëpo, gjithsesi ne e falenderojmë për punën dhe ti nuk je zyrë ligjore, por ti e ke dhënë maksimumin tënd.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për dhe 1 votë abstenim u pajtuan që në të ardhmen të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, sipas Ministrive të linjave.

Enver Gashi – Paraqiti kërkesën nga DMM-ja, për plotësim ndryshimin e Rregullores për menaxhim të mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Labinot Mirena – Ne si grup parlamentar nuk kemi asgjë për diskutim.

Sami Ahmeti – E njëjta Rregullore na ka ardhë edhe në seancën e kaluar për me ndërrue një çmim sepse është bërë një gabim teknik, në rregullë e mirëkuptuam. Kësaj radhe, na ka ardhë Rregullorja për ndryshim të disa neneve, mirëpo dokumenti të cilin ju na keni ofruar nuk përkon me dokumentin i cili është miratue në Kuvendin komunal. Rregullorja që na ka ardhë neve me nr.07/2022, në emailin e fundit nuk janë rekomandimet tona, që janë miratuar në këtë Kuvend, a ka përfaqësues të zyrës ligjore, apo dikush që është marrë me këtë sepse definitivisht nëse, është kështu ne do ta dërgojmë direkt sot kërkesën në MAPL, për me pa se çfarë Rregullore po miratojmë. Për Rregulloren e parë që është miratue i kemi dhënë vërejtjet dhe sugjerimet tona, të cilat përmes emailit i kemi konfirmue me zyrtarët ligjor. Në ndërkohë neve, na ka ardhë Rregullorja në email, verzioni i parë i saj para miratimit, ose pa rekoamndimet tona. Unë kisha pasë dëshirë me ditë këtë çështje para se të shkon në votim.

Berat Mehmeti – Unë në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, ju njoftoj se në kohën kur është bërë ndryshimi herën e fundit kam qenë në pushim vjetor, realisht nuk kam qenë pjesë e atij ndryshimi. Tani, kur është bërë kërkesa e Ministrisë, që të harmonizohet neni 11 dhe 12, me plotësim ndryshimin e Ligjit për mbeturina, ka mundësi që ka ikë si lëshim teknik. Arsyeja është se unë kam qenë në pushim vjetor, kur e kanë dërguar te anëtarët e tjerë të Komisionit që e kanë përcjellë në Kuvend, ka mundësi që ka ikë Rregullorja e vjetër pa ndryshimet që i ka propozue LVV-ja dhe LB-ja. Ato ndryshime janë inkorporue në Rregulloren e kaluar para se me iu ndryshue çmimi, por nëse është ardhë Rregullorja para plotësim ndryshimeve atëherë, unë personalisht ju kërkoj falje, por kjo çështje do të rregullohet.

Sami Ahmeti – Në seancën kur është miratuar Rregullorja, ne i patëm bërë komentet tona, kryesisht te pika 6, nën pika 7,10 dhe 20. Pastaj te neni 11 dhe 12, ka pasë jopërputhje dhe tash nëse, po flasim për ndryshimet te neni 11 dhe 12, këto 2 Rregullore kanë komplet nene të ndryshme dhe e kanë konceptin komplet të ndryshëm. Tash, neve na ka ardhë një dokument për të cilin sot po presim me bë ndryshime, por neve na ka ardhë i pandryshuari dhe qysh besojmë ne që nuk po bëhen këso lloj parregullësish vazhdimisht. Ne do të votojmë kundër dhe ju vazhdoni sidoqoftë.

Ajet Berisha – E falenderoj Kryetarin e Komisionit që e sqaroi se në këtë drejtim kjo Rregullore ka ardhë para asaj që janë aplikue dhe përfshirë, do të thotë është një gabim teknik dhe një kërkim falje e singertë. Mendoj se për mua është krejtë në rregullë në rast se Rregullorja që do të dalë do të jetë me ato që i kemi sugjerue dhe i kemi votue në Kuvend. Unë e konsideroj si gabim teknik dërgimin e kësaj Rregulloreje në këtë mbledhje dhe e falenderoj Kryetarin e Komisionit për këtë sqarim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër morën Vendim për aprovimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Obiliqit, sipas kërkesës nga MAPL-ja, nr.435-2/23, e dt.09.02.2023, ku është kërkuar harmonizimi i Rregullores te dispozitat ndëshkuese që parashohin gjobat mandatore me Ligjin e ri për mbeturina nr.08/L-07, neni 49.

Enver Gashi – Paraqiti kërkesën nga DAP-ja, raportin për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave.

Lendita Bektashi – Ju njoftoj se është bërë përmbyllja e procesit zgjedhor të Këshillave lokale. Ky proces i organizuar nga Drejtoria e administratës dhe si kryesuese e këtij Komisioni së bashku me Komisionin e formuar nga Kuvendi komunal kemi udhëhequr procesin e 12 Këshillave lokale, apo të 12 zonave më shumë se 30 ditë. Procesi është monitoruar edhe nga Demokracia Plus dhe ka shkue shumë mirë përveç 2 incidente, që i kemi pasur në fshatin Palaj dhe në Plemetin. Mirëpo, bashkë me Komisionin kemi arritë me qetësie situatën dhe me i përfundue edhe ato 2 zona, si proces. Në 5 zona, e kemi përsëritë procesin e Këshillit për shkak se herën e parë nuk kemi pasë pjesëmarrës të mjaftueshëm për ta përmbyllë si proces. Sa i përket formimit të Komisionit të ankesave, e dijmë që ka shkue pak më gjatë për shkak të disa ankesave nga LVV-ja, dhe të përgjegjeve të MAPL-së, por në fund e kemi formuar edhe atë Komision. Ne kemi pritë ankesa nga ana e qytetarëve, por nuk kemi pasë asnjë ankesë të këtij Komisioni. Pastaj, i kemi shpallë vendimet për Kryetar të Këshillave lokal dhe të fshatrave. Unë e falenderoj shumë Komisionin, por më vjen keq se nuk

mund ta paguajmë asnjërin nga ju sepse nuk ka asnjë Udhëzim, asnjë Rregullore, që mund të thirremi dhe me ua bë pagesën

Ajet Berisha – Në rend të parë e përgëzoj Komisionin për punën që e kanë bërë edhe pse nuk kam ndonjë informatë. Mendoj se ne si Kuvend kishte me qenë mirë të njoftohemi me shkrim me na sjellë Komisioni, në këtë rast drejtoresha e administratës për procedurat që kanë shkue, për mënyrën dhe për njerëzit që janë zgjedhë. Mirëpo, edhe një element shumë i rëndësishëm, mendoj se duhet me u gjetë hapësira në momentin kur dikush merrë një detyrë shtesë, në këtë rast po flas për anëtarët e Kuvendit komunal dhe nuk po flas për të tjerët sepse Ekzekutivi i din punët e veta, i din Rregulloret, ku me u thirrë. Mirëpo, anëtarët e Kuvendit kanë bërë një punë shtesë në raport me mua, që nuk kam qenë në atë Komision. Konsideroj se duhet me u gjetë te Rregulloret për shtesa, te ngarkesa për punë shtesë dhe me u pague, që është korrekt. Qëllimi nuk është pse unë nuk jam dhe me thënë arsyetimi është se nuk kam ku me u thirrë. Mirëpo, duhet me gjetë mënyrën, duhet me nxjerrë vendimin për njerëzit që janë angazhue dhe kanë pasë probleme sepse e di kam marrë pjesë në këto takime në të kaluarën më shumë politike jo i imi, jo i yti se kujtojnë që po e bëjnë namin që po zgjidhet jo i këtij, apo atij. Pra, duhet me gjetë mënyrën këta njerëz që shkojnë dhe shpenzojnë energji, marrin nervozë dhe fyhen në rastet e caktuara, minimalisht me i pague. Drejtoreshë, është mirë me gjetë mënyrën dhe ka mënyra për pagesë për shtesa.

Valbonë Beka – Edhe unë e kam faktikisht të njejtin problem si të gjithë ta diskutoj. Ju, e dini vetë se keni qenë edhe ju pjesë e Komisionit dhe ne kemi humbë një muaj, pothuajse gati çdo ditë kemi marrë pjesë në mbledhje dhe kemi humbë koga kohë të madhe. Nëse, është mundësia dhe për derisa viteve tjera është pague atëherë, pse të mos gjendet edhe tash mundësia të na paguhet ajo punë që e kemi bërë.

Lendita Bektashi – Kryesues, me të drejtë e ka z.Berisha, që po kërkon sqarim rreth këtij raporti. Ne jemi në përpunim të këtij raporti dhe do të ua dorëzojmë në seancën e ardhshme, ndërsa, sa i përket mënyrës së pagesës, unë thashë se nëse gjejmë një Udhëzim administrativ, ose një Rregullore se ku mund të thirremi patjetër se do të ua bëjmë pagesën.

Enver Gashi – Ju njoftoj se në mbledhjen e KPF-së, i kemi shqyrtuar disa kërkesa, të cilat ua kemi drejtue Drejtorive përkatëse për shqyrtim.

Kemi kërkesën nga Fazli Përvetica, për ndërtimin e një objekti për të pritë të pamen në lagjen Koskovik, në Breznic, dhe këtë kërkesë e kemi dërgue për shqyrtim në DSHPE.

Pastaj, kemi kërkesën nga Muhamet Berisha, nga fshati Plemetin të cilit i është djegë baraka dhe kërkon ti ndërtohet shtëpia, ose ti mundësohet pagesa e qirasë. Këtë kërkesë e kemi dërguar për shqyrtim në DSHPE. Po ashtu, kemi edhe kërkesën nga Arbër Behrami, lagjja e Koliqëve të cilët janë kategorikisht kundër shfrytëzimit të kësaj rruge për zhvillime biznese. Këtë kërkesë e kemi dërguar për shqyrtim në Drejtorinë për infrastrukturë.

Pika 7 e rendit të ditës

Enver Gashi – Ju njoftoj se në KPF, është kërkuar një raport nga NPL “Kastrioti” dhe ne kemi biseduar me këta dhe me Drejtorinë që e monitoron, ata jepin raport në muajin mars, do të thotë në mbledhjen e ardhshme do ta kemi të gjithë raportin. Po ashtu, ishte edhe një kërkesë për kujdestari të barnatoreve, që ne shumë herë e kemi trajtuar këtë temë, por nuk kemi mund me bë zgjidhje sepse ose ne nuk kemi qenë të gatshëm, ose shoqata e barnatoreve nuk ka qenë e gatshme me zgjidhë këtë problem. Mendoj se duhet me autorizue DSHMS-në, ti mbledhë farmacistat që i kemi dhe ta diskutojmë këtë çështje.

Sami Ahmeti – Duke qenë se këtë temë e fillova unë dhe thashë edhe në KPF se nuk jam i pari që e ceku sepse shumë prej juve, ndoshta në seancat e kaluara, në mandatet e kaluara e keni bisedue këtë çështje. Ne morëm përgjegje se është problem për shkak se barnatoret, ose pronarët e tyre shprehen se ndjehen të pasigurtë, kështu u tha në KPF. Pastaj, sa kam informata unë problemi kryesor është qëllimi i jollogarisë që e kanë me punue natën. Qëllimi i pyetjes time dhe kërkesës tonë është që ne me shqyrtue mundësinë sikurse që u bisedue për

çështjen e kompensimit të Komisioneve, me shqyrtue mundësinë e kompensimit, ose njëfarë mënyre e subvencionimit të barnatoreve, që qytetarët të marrin 24 orë shërbime. Mendoj jo secilës, jo paga

mjaftueshëm sa ata kërkojnë, por edhe e kanë obligim ligjor për faktin se i shërbejnë shëndetit publik. Është shumë me rëndësi që në Komunën tonë me qenë së paku 1 barnatore pas asaj kohe, për asrye se për një punë shumë të vogël po iu bjen qytetarëve me shkue edhe në Prishtinë. Unë e di që është vështirë, por baza ligjore mund të gjendet sepse shumë herë po subvencionohen pa dashtë me etiketue askend, po subvencionohen persona, ose ndërmarrje që i shërbejnë vetëm vetes së tyre dhe familjes së tyre. Në këtë rast ne mendojmë që është e mundshme me u bë një

diçka e tillë që edhe pronarët e barnatoreve mos me i dëmtue, por në të njejtën kohë me rëndësi nëse, flasin dhe thonë që qytetarët janë numër 1 për neve, me iu shërbye atyre. Atë ditë në fund të fjalës time e mori fjalën edhe z.Labinot dhe tha se ka folë me drejtoreshën dhe janë në përfundim të kësaj pune që me bë caktimin e barnatoreve kujdestare. Nëse, është drejtoresha këtu, e kisha lutë me mirëkuptim që të na jepë një shpjegim se a është duke u bisedue në këtë çështje, apo nëse veç është duke u bërë diçka ne po flasim kot, se atje po merret vendimi.

Enver Gashi - Unë në fillim thashë se ne e kemi DSHMS-në, ose DSHPE-në dhe ajo duhet të merret me këtë çështje, e jo ne të merremi para Drejtorisë sepse ne jemi ata që e vendosim. Ne jemi për me bë zgjidhje, por së pari Drejtoria le ta shqyrton, pastaj vjen te ne.

Ajet Berisha – Ky është një problem i vjetër prej se jam në Kuvendin komunal, do të thotë që nga viti 2013, 2014 është diskutue, por asnjëherë nuk është gjetë një zgjidhje. Mendoj se më shumë se aspekt ligjor është një aspekt moral, mirëpo edhe një aspekt i krizës. Unë punoj në njësinë e urgjencës dhe përveç kujdesit ndaj pacientit dhe qytetarit që me kursye kohë dhe me kursye shpenzim mendoj se në rrethanat çfare jemi qe 2,3 vjet, është shumë e rëndësishme edhe aspekti etik se nuk të jepë kohë me shkue deri në Prishtinë, për me marrë një barnë që ne duhet me aplikue në atë moment. Shumë shpesh kemi emergjenca të tilla që koha është shumë me rëndësi për pacientin. Fatkeqësisht, në rrethanat çfare jemi ne jemi furnizue mjaft dobët dhe po duhet me planifikue afatin e barnave esenciale një barnë kundër alergjisë, apo një diçka tjetër duhet me kalkulue në emergjencë sa ka afat, sa me rue, kujt me i thonë shko bleje, e kujt jo. Shumë shpesh ata munden me vërejtë se ne e kemi një barnë të caktuar me i thënë shko bleje sepse ne nuk jemi të sigurtë se do të furnizohemi me atë barnë dhe ai mund të thotë e paske, pse po thua shko bleje. Duke pasë parasysh se pas orës 11 ne nuk kemi ku me i thënë shko bleje, e ka një krizë hipertenzive dhe nuk ke çka i jepë, ai duhet me shkue në Prishtinë, paramendo kohën me shkue me ble atje, me u kthye këtu që me aplikue atë barnë. Më e lehtë është me marrë me vendos në emergjencë me dërgue drejtë sepse sa koha shkon, që ai me ta sjellë atë barnë. Kjo është e rëndësishme për 2 elemente, e para kursen kohë edhe mjete, e dyta kursen jetë neve, na mundëson kur nuk jemi mirë të furnizuar atë barnë me dalë me ble shumë shpejtë dhe me aplikue. Pra, është shumë e rëndësishme me gjetë një bashkëpunim, e ky bashkëpunim do të nënkuptoj mirëkuptim me barnaret.

Është e vështirë me i detyrue, por njëfarë lloj mirëkuptimi dhe nuk është siguria sepse shumica e barnatoreve në Prishtinë, as ato nuk kanë siguri. Këta, nuk punojnë nga se nuk kanë interes të madh dhe puna pas orës 11 në Obiliq, nuk është aq e madhe që këta kanë me bë ndonjë shitje. Mirëpo, ai duhet me nejtë për qytetarin për me kursye kohën, shpenzimet dhe jetën e tij.

Enver Gashi – Unë prej se jam këtu, është mandati i tretë gjithë e kemi debatue këtë çështje dhe kemi qenë për me bë zgjidhje, por kurrë zgjidhje nuk kemi bë. Për këtë unë thashë Drejtoria duhet me analizue mirë çështjen nëse, është mundësia e subvencionimit me ndihmue sepse një jetë e njeriut është shumë më e madhe se krejtë paratë e Komunës. Mendoj se edhe këta, të barnatoreve duhet të kthehen pak nga popullata sepse është keq me na thënë dikush nga personeli shëndetësor se për një barnë sikur te kishim pasë 5 minuta, më heret se na shkoi një njeri. Unë po e ndjej veten keq edhe pse nuk jam farmacist, por jam pjesë e këtij Kuvendi dhe kësaj shoqërie.

Fidan Ahmeti – Unë në këtë rast i përfaqësoj të gjitha barnaret, në njëfarë forme më kanë autorizue. Për çështje humane, ne qysh prej ores 9-12 rrijmë të gjithë dhe këtu kemi edhe personal mjekësor që e dijnë se nuk ka punë që ia vlen me nejtë, që nuk i mbulon as shpenzimet. Ne e kemi praktikue kujdestarinë qysh në kohën kur ka qenë mjek z.Ibush Mjekiqi dhe z.Haki Jashari. Ju betohem, më falni në shprehje se përveç

qenve njeri i gjallë nuk lëvizte, as policia, aq të përfshin një panikë që nuk vjen në shprehje me pasë pacientë në shumë raste. Fatkeqësisht, natën nuk ka kujdestari vetëm në raste emergjente, shumica dedikohen për Prishtinë, terapi nuk ka dhe mjekët e dijnë shumë mirë. Ne jemi barnatore private dhe tash me marrë lajmin se më ka vdekë baba, unë duhet me mbyll. Nuk jemi institucion publik, nuk kemi asnjë broxh moral përveç që ndjehemi human që e mbajmë me orë me humbje disa barna, që kushtojnë 40 centë, por dikujt ia ndalë dhimbjen. Në Vushtrri psh janë 25 barnatore, që i bjen

çdo të 26 ditë, me kujdestari ndërsa te ne na bjen çdo javë me nejtë 24 orë. Mendoj se nuk është gabimi ynë, por është gabimi i shtetit, i Ministrisë së shëndetësisë sepse nuk i ka barnat esenciale dhe të gjithë e dijmë se për një hipertension ia jepë një ampullë lasiks, pastaj plus 6 orë i zbret tensioni, shkon te mjeku i vet ai që e ka mjekun e vet. Përndryshe, nuk mund të mbajmë 24 orë kujdestari, duke u nisë prej sigurisë, shpenzimeve që duhet të paguhet një punëtor ekstra dhe shpenzimeve tjera. Ne jemi për me të zgjidhje, por jo me u dëmtue ne sepse fundja ekziston barnatorja në QKMF dhe paguhet njerëzit për atë barnatore, ndërsa barnat duhet me qenë në kushte normale në QKMF, e jo me pasë varësinë nga barnatoret private.

Sami Ahmeti – Unë e kam edhe një çështje, e di se nuk ka ndërlidhje direkte me Komunën dhe me Ekzekutivin, është çështja e ujësjellësit në Milloshevë. Në 2 muajt e fundit, pjesa më e madhe e Milloshevës nuk ka pasë ujë ndërsa, arsyetimet e ujësjellësit janë se herë nuk ka shtypje, herë janë ndërrue gypat, herë diçka e tillë. Si institucion derisa funksionojnë në territorin e Komunës së Obiliqit, i kisha rekomandue Ekzekutivit që me bisedue me këtë institucion dhe me qenë më serioz. Unë e di se problemi nuk është vetëm në Milloshevë, por kemi pasë raste edhe në Mazgit dhe në pjesë tjera, që më duket se është njëfarë joserioziteti në raport me punën që po e bëjmë. Shumë herë një prishje, ose hiç pa pasë prishje e kanë gjetë atë fjalinë e famshme e kemi ekipin në terren, janë duke punue dhe së shpejti do të rregullohet. Kur e dijmë se uji është më i rëndësishëm për jetën, e di prapë po e ripërsërisë nuk ka të bëjë me punën e Ekzekutivit, por është një kompani që merret me atë punë. Mirëpo, Ekzekutivi ka mundësi me ia dhënë një rekomandim dhe duhet me punue pakëz më mirë në këtë drejtim. Në fund, deshta me iu uru të gjithëve juve edhe kolegëve asambleistë ngritjen e pagës dhe me falenderue grupin parlamentar të LVV-së.

Ajshe Haliti Pllana – Unë e kam një kërkesë dhe një pyetje. Pyetja shkon për drejtoreshën e shëndetësisë, deshta me ditë se a ka me fillue, ose kur ka me fillue prapë me u bë PAP testi papagesë në QKMF, pasi që dihet se është një test shumë i rëndësishëm për të gjitha femrat. Kërkesa tjetër, shkon për të gjithë duke filluar prej Kuvendit, Kryetarit, Nënkryetarit, Drejtorive që me gjetë një mënyrë për me i ndihmue fëmijët të cilët janë diagnostifikue me sëmundjen e tumorit, ose kancerit. Fatmirësisht, në Komunën tonë nuk është edhe shumë numri i madh i këtyre fëmijëve, megjithatë ata fëmijë të prekur nga këto sëmundje ti ndihmojmë në një mënyrë ose me një shumë më të madhe. Unë e di rasti i fundit që ka qenë tash para 2 jave, e di që Komuna e ka ndihmue, por ka qenë një shumë simbolike edhe pse ajo shumë simbolike është shumë e rëndësishme për atë fëmijë. Megjithatë, duhet me gjetë një mënyrë ne bashkarisht të gjithë, ose me nda një shumë në bazë të sëmundjes së atyre fëmijëve, që edhe Komuna si Komunë të iu ndihmoj atyre familjeve, atyre fëmijëve që të kenë një fëmijëri si të gjithë fëmijët tjerë.

Albana Shillova Shalaku – Unë e kam një kërkesë nga disa banorë të fshatit Hamidi, janë dikund rreth 15 nxënës, që vijojnë mësimin në shkollën e Sibofcit. Është një distancë 2.4 km largësi, nuk është aq e madhe, por është një zonë që është e rrezikshme kryesisht për fëmijët e vegjël nga qentë endacakë derisa të mbërrijnë. Edhe prindërit e tyre kërkojnë që të sigurohet transporti për këta fëmijë.

Valon Svirca – Në Mazgit të Ulët rr. "Ali Podrimja" nuk është asfaltue, do të thotë më ka ardhë kërkesa për me asfaltue, si pyetje çka ka mund me ndodhë, pse ka mbetë pa asfaltue.

Valbonë Beka – Ne jemi këtu, për me i paraqitë edhe kërkesat e qytetarëve. Në seancën e kaluar e kam paraqitë një kërkesë të qytetarëve të Mazgitit të Ulët, është problemi i ndriçimit. Pra, ka qe një muaj dhe aty kurgjë nuk është bërë për ndriçim. Një pjesë e madhe pothuajse, shumica kanë mbetë në errësirë, ku është problemi, a ka mundësi me ditë sepse qe një muaj mos me u rregullue kurgjë bash asnjë dritë, disi sikur po flasim kot.

Ibush Mjekiqi – Pyeti se a e din procedurën, a ka procedurë.

Valbonë Beka – Unë nuk e di, nuk e kam atë përgjegjësi dhe për atë po pyes pse nuk është bërë asgjë që një muaj. Përgjegjësi e imja është me paraqitë problemin.

Fidan Ahmeti – Kam kërkesa prej shumë bizneseve, kryesisht në Obiliq që të dielën të kenë pushim psh pothuajse çdo kafe, shumë markete na e kanë bërë këtë kërkesë që me paraqitë në Kuvend. Pra, me pasë të dielën pushim, ose me u formue një lloj Komisioni i cili psh i bën me rrotacion, ashtu qysh ne e kemi kujdestarinë të dielën psh një barnatore funksionon një të diele. Unë nuk po them të gjitha lokalet, por shumica e lokaleve ma kanë adresuar këtë kërkesë si me shkrim ashtu edhe me gojë.

Jeton Mjekiqi – Unë e kam një shqetësim sepse bageri u afrue shumë veç e mori rrugën, për Grabofc-Shipitullë. E kemi një kërkesë dhe e di se u diskutue, me KEK-un, por çfarë veprimi duhet me marrë për me çelë nga 01, për Palaj me dalë sepse aty edhe një javë, mund të fillojnë reshjet. Nëse, shkohet për Sibofc, edhe kilometra shumë dhe aty rruga nuk është e mirë, kështu që kjo është kërkesa ime me shikue si Kuvend, ose me bërë një kërkesë, ose diçka çka ka nevojë me bërë, të konsultohemi edhe me drejtorin përkatës.

Labinot Mirena – Deshta me falenderue z.Sami, që e citoi kryesisht për rrogat që na u kanë rritë dhe ia uroj zajednicën, ju priftë e mbara.

Sami Ahmeti – Unë e falenderoj që po e rritë veten në atë nivel që me u marrë me çështje të mëdha. Mendoj se është mirë me u fokusue poshtë dhe e kemi një person i cili e përfaqëson Kosovën në formën më të mirë të duhur. Edhe ato zajednicat qysh po i quan ti i kanë bërë të tjerët, që nuk po të fajësoj ty, por definitivisht nuk e kisha pritë këtë fjalë me folë në Kuvend komunal sepse nuk i shërbejmë askujt. Unë mendoj shumë se nuk do të ketë zajednicë, por do të ketë përfaqësim shumë të mirë të shtetit tonë dhe ke me pa edhe vetë se qysh ka me funksionue.

Ibush Mjekiqi – Është e vërtetë se ka pasë vështirësi, ose pengesa me furnizim me ujë jo vetëm në Milloshevë, por edhe në pjesët tjera, sidomos në kohën e reshjeve për shkak se kapaciteti i fabrikës për prodhimin e ujit ka qenë i limituar për arsye të ndotjeve. Do të thotë se reshjet kanë qenë ato, që e kanë shkaktue problemin për furnizim me ujë. Ne kemi qenë në dijeni dhe në kontakt të vazhdueshëm me kompaninë rajonale ujësjellësi, por në kohën e fundit është stabil furnizimi me ujë përveç në disa zona të Obiliqit, ku është duke u punue me rrjetin e shpërndarjes. Pengesa ditore ka, por këto nuk janë pengesa të theksuara. Ishte një pyetje lidhur me Drejtorinë e shëndetësisë për PAP testin dhe unë mund të them se në QKMF dhe në sistemin në përgjithësi në shëndetësi shërbimi jepet përmes 3 niveleve. Në QKMF ekziston sektori i gjinekologjisë dhe e kemi të punësuar gjinekologun aty, kështu që të gjitha shërbimet e kujdesit primar ato merren për çdo ditë. Unë e di se PAP testet janë bërë më heret kohë pas kohe dhe tash do të bëhen. Te fëmijët me kancer, për fat të mirë nuk kam informata më shumë.

Ajshe Haliti Pllana – PAP testi më heret është bërë në Komunën e Obiliqit në QKMF dhe është bërë papagesë. Pastaj, është bërë në një mënyrë tjetër, që i kanë dërguar privat, por ajo ka qenë kërkesë e qytetarëve, apo atyre që nuk e di qysh ka qenë.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se shërbimi shëndetësor në Kosovë është i rregulluar në 3 nivele në bazë të Ministrisë së shëndetësisë dhe dihet saktë se çfarë shërbime ofron kujdesi primar shëndetësor. Në organizimin e mjekësisë familjare që ende nuk ka përfunduar si process, absolutisht niveli gjinekologjik i takon nivelit të dytë që për fat të keq në regjionin e Prishtinës, nuk e kemi ende spitalin e Prishtinës. Pra, ka probleme mjaft në shëndetësi që kërkojnë kohë me u zgjidhë.

Ajshe Haliti Pllana – Është bërë papagesë dhe unë kërkoja që me fillue PAP testi papagesë dhe kur fillon.

Ibush Mjekiqi – Është bërë edhe mamografi një kohë dhe unë e thashë atë që di. Për fat të mirë për subvencionim të fëmijëve me kancer numri i tyre nuk është i madh, por edhe një me qenë është shumë dhe ne mundohemi prej kategorisë së subvencioneve ti subvencionojmë. Mirëpo, ky shërbim është i nivelit të tretë në klinikën e onkologjisë në Prishtinë dhe terapia merret aty. Po ashtu, rastet që nuk mund të trajtohen në QKUK, trajtohen ose udhëzohen përmes një Komisioni për shërim jashtë vendit dhe përpara ka qenë një sektor për subvencionim fondi i sigurimeve shëndetësore, por ka probleme që sigurisht i dini si informacion plus ka hy në borxh për 30 milionë euro. Sa i përket transportit të fëmijëve të fshatit Hamidi dhe disa lagjeve të Sibofcit, shkojnë në shkollën “Migjeni” në Sibofc, por sigurimi i transportit rregullohet në bazë të

një ligji që është 3 km dhe ky është nën 2.5 km. Unë personalisht e di se shumë prindër dhe lagje vetë e organizojnë transportin por sido që të jetë nëse, ka mundësi në të ardhmen e shikojmë, mirëpo në këtë vit nuk kam shpresë se mund ta realizojmë. Rruga “Ali Podrimja” në Mazgit ka fillue një herë dhe është ndërprerë për shkak të problemeve që kanë qenë me banorë dhe kompaninë. Kërkesa që është bërë tani është në emër të qeverisjes komunale dhe mund të them se kjo rrugë këtë vit kur të vjen në muajin maj Qarkorja buxhetore, duhet të futet në buxhet për vitin e ardhshëm. Pra, për këtë vit nuk ka mundësi të rregullohet. Unë të inkurajoj ty dhe gjithë të tjerët, që kur bëhet planifikimi për investime kapitale për vitin e ardhshëm këto, të futen në buxhet dhe të rregullohen me kusht që të bisedohet edhe me banorët në mënyrë që mos të ketë problem. Ishte një pyetje nga znj. Valbonë Beka, për ndriçimin të cilin pa kontratë nuk mund ta bëjmë, për atë edhe reagovala pieta, se a i din procedurat sepse duhet me lidhë kontratë dhe sinqerisht për çdo ditë kam pyet sepse kontrata ende nuk është lidhë për shkak të procedurave. Po ashtu, nuk mund të rregullohet asnjë dritë sepse nuk është kompania e kontraktuar për mirëmbajtje të ndriçimit. Ju thatë, se nuk keni mund për një muaj ditë as një dritë me rregullue, por sinqerisht nuk mundemi përveç nëse, dikush merrë iniciativë privat me bë, që edhe atëherë duhet me marrë leje. Po ashtu, ishte një kërkesë që dita e diel të jetë pushim për shumicën e bizneseve dhe nëse, ata e vlerësojnë se duhet me bë një gjë të tillë atëherë, duhet ta bëjnë kërkesën me shkrim dhe ne do të veprojmë konform ligjit. Ne jemi të gatshëm bashkarisht me bë një Rregullore për bizneset e ndryshme, pse mos me pasë 1 ditë pushim, fundi i fundit punëtorit i takon.

Ajet Berisha – Në këtë rast mu dukë z.Fidan sikur me qenë sindikatë e punëtorëve për me i mbrojtë të drejtat e punëtorëve, me siguri pronarët nuk kanë thënë. Vërtetë, pronarët mund ta bëjnë si rregullë të pushojnë të shtunën dhe të dielën.


Ibush Mjekiqi – Te çështja e rrugës, është shumë e vërtetë dhe monitorimi, ose inspektimi ynë është në baza ditore. Ne kemi raporte të hartuara dhe inspektime nga Drejtoria e inspeksionit, Drejtoria e mjedisit dhe shkresa e fundit është ripërsëritë dhe është kërkuar takimi me përfaqësues të KEK-ut, të nivelit më të lartë, por ende përgjegje nuk kemi. Ne jemi duke e përcjellë në mënyrë të vazhdueshme dhe duke e përsëritë kërkesën, por nuk është vetëm ajo rrugë sepse ka edhe kërkesa tjera, do të thotë pa biseduar me ata ne nuk mund të marrim vendim. Sido qoftë në baza ditore, ne jemi duke i përcjellë zhvillimet në atë zonë ku është duke operue mihja e dheut për zgjerimin, ose për nxjerrjen e thëngjillit.

Albana Shillova Shalaku – Meqë, jemi në prag të festës së 8 Marsit-Ditës ndërkombëtare të gruas, ne e rekomandojmë Drejtorinë e Arsimit, që ti udhëzoj shkollat që orën e parë mësimore shkollat të ia kushtojnë kësaj dite, duke iu ligjëruar nxënësve për sakrificën e nënave, bashkëshorteve, motrave etj.

Mbledhja përfundoi në ora 12:29'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Anëtar i më i vjetër i Kuvendit Komunal

Enver Gashi
